



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 15, datë 22.01.2019

MBI

NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL NË KUADËR TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË GJYQTARËVE

Këshilli i Lartë i Gjyqësor i mbledhur më datë 22.01.2019, bazuar në nenin 171 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 62, pika 14 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke vlerësuar rëndësinë që ka Këshilli në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi vlerësoi situatën aktuale në të cilën po ecën ky proces,

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të subjekteve të tjera të rivlerësimit, me këtë përbërje:
 1. Z. Dritan Hallunaj – kryetar
 2. Z. Maksim Qoku – anëtar
 3. Z. Medi Bici – anëtar
 4. Z. Erjon Muharremaj – anëtar
 5. Z. Ilir Toska – anëtar
2. Komisioni koordinon punën e tij me institucionet e rivlerësimit si dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor për përmbushjen e detyrave të tij përgjatë këtij procesi.
3. Komisioni ndjek punën për planifikimin e shorteve sipas kalendarit të caktuar me KPK-në, në mbledhjen e statistikave, caktimin e inspektorëve përgjegjës, marrjen e masave për zhvillimin e shortit, gjurmimin dhe mbledhjen e dosjeve të përzgjedhura me short, hartimin e raportit, inventarizimin dhe dorëzimin e raportit pranë KPK-së.

4. Merr masa dhe orienton administratën të bëjë njoftimet në lidhje me kryetarët e gjykatave apo gjyqtarët që do shortohen.
5. Komisioni të miratojë rregulla për funksionimin e veprimtarisë së tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR